



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:180209

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05678349

C.nr.1676/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarin Taulant Rexhëbeqaj, në çështje juridike kontestimore të paditësit: S.V. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensim dëmi, jashtë seance, më datë 13.05.2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit S.V. nga Prizreni, *me të cilën ka kërkuar që të “ Aprovohet padia dhe kërkesë padia e paditësit S.V. nga Prizreni, në tërësi si e bazuar obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë - që në emër të dëmit për të gjitha kategoritë e dëmit paditësit të ia kompensoi shumën prej 1.500.00 eu, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim, si dhe t’ia paguajë shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim ”. si e pabazuar.*

A r s y e t i m

Paditësi S.V. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij, av D.M. nga Prizreni, me datën 16.08.2021, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, duke theksuar se me datë 30.07.2021, ka ndodhur aksident i komunikacionit, ku deri tek aksidenti ka ardhur instruktori i Auto Shkollës AB-eks me automjetin “Golf 1K” me targa të regjistrimit ishte duke lëvizur nga Prizreni për në drejtim të lagjes Arbana duke trajnuar kandidatin për patentë shofer dhe kur arrin përball marketit Kastrati e urdhëron të kthehet në gjysmë rreth kandidatin duke mos e marr parasysh sigurinë e pjesëmarrësve në trafik dhe në këtë rast i pengon vozitësit B, tipit “Audi A4” me targa të regjistrimit ngjyrë e zezë, Automjeti A si shkaktar i aksidentit në momentin e shkaktimit të aksidentit ka pasur të kontraktuar sigurimin te kompania e sigurimeve K,S “Illyria”.

I autorizuar i paditësit me parashtrësën e datës 30.04.2024 për heqjen dorë nga kërkesëpadia e njofton gjykatën se me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore dhe mbi këtë bazë nuk ka interes për vazhdimin e procedurës një kopje të marrëveshje jashtë gjyqësore i ka bashkangjitur parashtrësës.

Me nenin 3 par. 1 të LPK-së është paraparë se *“Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko – civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës”*, ndërsa me par.2 të këtij neni është paraparë se *“Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë pajtim gjyqësor lidhur me kontestin e tyre”*.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”* – pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 3 par. 1 dhe par. 2, lidhur me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1676/2021, datë 13.05.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.